



REPUBLIKA E SHQIPËRISË

ENTI RREGULLATOR I ENERGJISË

Sekretaria

Nr. Prot.

Tiranë, më .02.2025

**MBLEDHJA Nr. 11,
Datë 03.03.2025, ora 11:00
e Bordit të ERE-s**

Në zbatim të (i) nenit 13 dhe 16, të Ligjit Nr. 43/2015, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”; i ndryshuar, (ii) nenit 9, të “Rregullores së Brendshme të Organizimit dhe Funkcionimit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE)”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 199, datë 27.11.2020, e ndryshuar dhe (iii) nenit 8 dhe 11, të “Rregullores për Organizimin, Funkcionimin dhe Procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e bordit të ERE nr. 96, datë 17.06.2016, njoftojmë se **ditën e Hënë, datë 03.03.2025, ora 11:00**, do të zhvillohet mbledhja nr. 11 e Bordit të ERE-s, sipas këtij rendi dite:

1. Mbi kërkesën e shoqërisë “DELIU 3D” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
2. Mbi kërkesën e shoqërisë “RENEW” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
3. Mbi kërkesën e shoqërisë “GREEN ENERGY” sh.p.k. për licencim në veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike.
4. Mbi kërkesën e shoqërisë “GREEN ENERGY TRADING ALBANIA” sh.p.k. për heqjen e licencës në veprimtarinë e tregtimit të energjisë elektrike.
5. Mbi kërkesën e shoqërisë “GREEN ENERGY BILISHTI” sh.p.k. për dhënien e autorizimit nga ERE për vendosjen e kuotave të saj si mjet për garantimin e detyrimit ndaj të tretëve.

Palët e interesit për pjesëmarrje në mbledhjen e bordit të ERE-s, në ambientet e ERE-s ose nëpërmjet platformave të teknologjisë së komunikimit elektronik (online), duhet të dërgojnë me shkrim kërkesën për pjesëmarrje, në postën elektronike, në adresën erealb@ere.gov.al, jo më vonë se 24 orë para datës së njoftuar të mbledhjes, si dhe mënyrën e pjesëmarrjes dhe çështjen të cilën janë të interesuar të ndjekin.

**KRYETARI
Petrit AHMETI**